



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr. 361/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 07.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, A.nr.361/2025 e datës 04.02.2025, e paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datën 04.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në cilën pretendohet se më datë 24 janar 2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka parashtruar ankesën nr.173/2025, me të cilën ka pretenduar se deputeti nga radhët e PDK z. Xhevahir Geci ka vendosur banerët/posterët në hapësirë publike në ndërtesë të banimit kolektiv në Rr. "18 qershori" në Skenderaj, në kundërshtim me dispozitat ligjore. Sipas parashtruesit të ankesës PZAP, përmes vendimi A.nr. 173/2025, të datës 26 janar 2025, ka nxjerrë vendim me të cilën e ka refuzuar ankesën nr. 173/2025 të parashtruar nga subjekti politik LVV, ashtu që ka konstatuar se veprimet e ankimuar nuk përbëjnë shkelje të nenit 34, pika 1, nën par. 1.2 të LZP-së. Ndërsa, më datë 03 shkurt 2025, në ora 18:00/h, duke qenë në njohuri se PZAP lidhur me këtë banerë/poster ka nxjerr vendimin A.nr. 173/2025, me të cilën ka refuzuar ankesën e tyre, Lëvizja Vetëvendosje me qëllim të vënies në lajthim të PZAP, ka abuzuar me të drejtën e ankesës duke parashtruar ankesën nr.338/2025, me të cilën ka pretenduar se z. Xhevahir Geci ka vendosur banerin/posterin në hapësirat publike, respektivisht në Rr."Bekim Berisha" përball QKMF^s në Skenderaj, ndonëse ka qenë në njohuri se në lidhje me këtë banerë veçse është

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 361/2025 më datën 07.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.